



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot

Jorgucat, me 30.09.2025

Lenda: Njoftim për Konsultim me Publikun

Ne zbatim të nenit 18 dhe nenit 54, shkronja e ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në zbatim të Rregullores së Keshillit Bashkiak Dropull, Për konsultime Publike"

Keshilli Bashkiak dhe Bashkia Dropull do të organizojnë degjësat publike mbi projektaktet e mëposhtme:

Titulli i Projekt-aktit :

1. Projekt Vendim "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026". 2. Projekt Vendim "Për miratimin e Paketës Fiskale 2026".

Propozuesi : Projekt –aktet janë propozuar nga Kryetari i Bashkisë.

Sqarime për projekt-aktet : 1- Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve .

2-Paketa fiskale për këtë periudhë parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve, duke marrë në konsideratë:

- Kapacitetet fiskale të tatimpaguesve
- Rritja e të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);

- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Analiza një për një e çdo takse &tarife, duke pare faktorët që ndikojne në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Konsultimi publik do të realizohet në përputhje me Kalendarin e Konsultimit Publik

Pjesëmarrës : Këshilli bashkiak Dropull,

Nga ana e Bashkise : Kryetari i Bashkisë,

Drejtues/punonjës të administratës/ drejtues te tjere te programeve buxhetore.

- **Nga komuniteti :** Banorët e Bashkisë sipas te gjitha njesive administrative , Shoqata e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe Kryetarët e Fshatrave.

Kalendari i Konsultimit Publik

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Dropull i Siperm	08.10.2025	Vrisera	09.00	Takim publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Dropull i Poshtem	08.10.2025	Sofratike	12.00	Takim publik	bisede
3	Konsultim publik me banorët e Njesise Administrative Pogon	20 10.2025	Poliçan	10.00	Takim publik	bisede

Kryetare e Keshillit

Donika Bauci